



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion
Mbledhja nr. 11/2010

Prishtinë më 16.03. 2010, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

**I mbledhjes së Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport
dhe Telekomunikacion**

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare, Ethem Çeku, Sala Berisha –
Shala, Zef Morina, Qamile Morina, Mufëra Şinik, dhe Kaqusha Jashari.

Munguan: Slobodan Petroviq, Fatmir Rexhepi dhe Nerxhivane Dauti.

Pjesëmarrës të tjerë: Isemt Shala, Dukagjin Shala, Krenare Sfishta dhe Fazli Bektashi –
MEM, Ibush Jonuzi dhe Ahmet Tmava – KPMM, Bill Klawonn dhe Haxhi Gashi –
USAID, Visar Ramaj – KDI, Behar Xharra - UNDP dhe Ibrahim Krasniqi - konsulent.

Stafi mbështetës: Hasan Tahiri, Advije Morina, Armend Ademaj dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi: Myzejene Selmani – kryetare.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d i d i t e

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbajtur më 09. 03. 2010,
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-163 për miniera dhe minerale,
4. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 09. 03. 2010

Sala Berisha – Shala – Paraqiti vërejtje në pikën III (tretë) të rendit të ditës, tek amendamenti 11, duhet të jetë rezultati i votimit “tre (3) me tre (3)”.

Qamile Morina – Paraqiti vërejtje në pikën III (tretë) të rendit të ditës, tek amendamenti 18 duhet të jetë “ligj për koncesione energjetike me kritere të përcaktuara”.

Kryetarja konstatoi se procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 09. 03. 2010 miratohet me vërejtjen e deputeteve Sala Berisha – Shala dhe Qamile Morina.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-163 për miniera dhe minerale

Kryetarja – Theksoi se kryesuesja e grupit të punës për Projektligjin nr. 03/L-163 për miniera dhe minerale, Sala Berisha – Shala, i paraqet amendamentet për shqyrtim dhe hapi debat.

Sala Berisha – Shala – Si kryesuese e grupit të punës për Projektligjin për miniera dhe minerale, para se t’i paraqiste amendamentet e Projektligjit nr. 03/L-163 për miniera dhe minerale, propozoi të përfshihen në Ligj Kristalet e Trepçës, për shkak të keqpërdorimit të tyre që behet vite me radhë.

Ethem Çeku – U pajtua në parim dhe kërkoi të gjendet zgjidhje për këtë çështje në ndonjërin nga krerët e Ligjit.

Zef Morina – Propozoi që një herë të kalojë ky projekt si tërësi, pastaj të shikohet mundësia se ku mund të përfshihen Kristalet.

Propozimi Zef Morinës u përkrah nga Komisioni.

Sala Berisha – Shala – Si kryesuese e grupit të punës i paraqiti amendamentet e Projektligjit nr. 03/L-163 për miniera dhe minerale, nga neni 55 deri në nenin 75, respektivisht 21 amendamente.

Vërejtjet:

Amendamenti 43

Neni 59 ndryshohet

Kreu 2

Bordi i KPMM-së: Themelimi, funksionet dhe organizimi

Sala Berisha Shala - Propozoi që paragrafi 5 i propozuar nga grupi i punës të jetë si vijon:

5. Anëtarët e Bordit, përfshirë edhe kryesuesin për Komisionin e Pavarur të Minierave dhe të Mineraleve, i emëron Kuvendi i Republikës së Kosovës.

5.1 Kandidatët për anëtarë dhe kryesues të bordit i përzgjedh Qeveria e Republikës së Kosovës nëpërmjet konkursit publik.

5.2 Qeveria e Republikës së Kosovës ia rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës listën prej 10 (dhjetë) kandidatëve të përzgjedhur.

5.3 Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion e bën intervistimin e dhjetë kandidatëve dhe përzgjedhjen e pesë kandidatëve, përfshirë edhe kryesuesin, që ia rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës për emërim.

Zef Morina – Theksoi se anëtarët e bordit i propozon Qeveria dhe i përzgjedh, por Komisioni i interviston dhe pastaj Kuvendi i emëron. Ishte i pajtimit që paragrafi 5 i grupit të punës vetëm të riformulohet. Po ashtu propozoi të futet në ligj, që së paku duhet të kandidohen nga 2 (dy) individë për një anëtar bordi. Rreth amendamentit të propozuar nga deputetja Berisha – Shala, tha se është më i thjeshtëzuar, por i paqartë.

Bill Klawonn (USAID) – Kishte një koment teknik, sepse sipas tij nuk mund të përcaktohet numri 10 (dhjetë) i kandidatëve, për shkak se mandati u kalon në periudha të ndryshme. Propozoi të sanksionohet me këtë ligj, që së paku skadenca e mandatit të jetë për nga 2 (dy) anëtarë të bordit përnjëherë.

Ethem Çeku – Theksoi se në esencë në të dy versionet nuk ka dallime të mëdha, por ne këtu duhet ta saktësojmë cilën anë ta mbështesim.

Qamile Morina – Tha se dallim thelbësor është që Komisioni po i ofron Kuvendit kandidatët e përzgjedhur dhe Kuvendit nuk po i jepet hapësirë të bëjë përzgjedhje. Propozoi që për çdo pozitë të caktohen nga 2 (dy) kandidatë, sepse mund të jenë mandatet të ndara.

Sala Berisha - Shala – Sqaroi se Komisioni është filtri i fundit, që e bën përzgjedhjen e kandidatëve, kurse Kuvendi është ai që vendos në seancë plenare.

Ethem Çeku – Ritheksoi se të dyja propozimet në esencë lejojnë mundësi që për çdo pozitë të propozohen nga 2 (dy) kandidatë, por ishte i mendimit që të kalojë amendamenti i grupit të punës.

Pas debatit të gjerë Komisioni me 5 (pesë) vota “Për” dhe me 2 (dy) vota “Kundër”, e miratoi amendamentin 49 të grupit të punës .

Amendamenti 50

Neni 68 ndryshohet.

Neni 68
Kryeinspektori

Ethem Çeku – Theksoi se është saktësuar qartë se kryeinspektori i përgjigjet KPMM-së, sepse ideja ka qenë të jetë një inspeksion i pavarur, por brenda kësaj të ruhet një vijë fuqizuese, d.m.th që u përgjigjet Bordit të KPMM-së dhe Kuvendit.

Sala Berisha-Shala – Theksoi se nuk është mirë që në këtë ligj të lejohet dualizmi dhe propozoi që neni 68, paragrafi 1 të duket si në vijim:

Neni 68
Kryeinspektori

1. Me Inspektoratin e Minierave udhëheqë kryeinspektori që i raporton Bordit të KPMM-së. Emërohet nga Komisioni i Kuvendit të Republikës së Kosovës për Ekonomi, Tregti, Industri, Energji, Transport dhe Telekomunikacion. Kandidatët për pozitën e kryeinspektorit do të përzgjidhen dhe propozohen nga KPMM-ja.

Qamile Morina – Theksoi se inspektorati duhet të jetë i pavarur, duke i marrë parasysh praktikat e shteteve të tjera, që i kanë edhe ligjet e veçanta për inspektoratin. Ajo propozoi që raportimi i Inspektoratit të jetë i drejtpërdrejtë në Kuvend.

Haxhi Gashi (USAID) – Qartësoi për deputetët se paragrafi 6 i nenit 68 mjaftë mirë e sqaron këtë çështje.

Ahmet Tmava (KPMM) – Theksoi se Inspektorati dhe KPMM-ja duhet t'i kenë politikat të harmonizuara që të mos ketë kontradikta në funksionimin e tyre.

Kaqusha Jashari - Propozoi që Inspektorati të jetë i pavarur, mirëpo e kundërshtoi idenë që Inspektorati të hartojë politika, kur dihet se ai vetëm i zbaton ato.

Bill Klawonn (USAID) – Theksoi se duhet t'i kemi parasysh nenin 67, paragrafi 2 dhe rekomandimet e KPMM-së, të cilat janë përfshirë në procesin e amendamentimit të këtij projektligji. Propozoi që Inspektorati të ketë shkallë të pavarësisë të funksionimit që të jetë jashtë kontrollit të ndonjë institucioni tjetër.

Zef Morina – Po ashtu kërkoi të shikohet neni 67, sepse është mjaft i qartë. Në qoftë se raporton, nuk do të thotë se mund të mos jetë i pavarur.

Pas debatit të gjerë Komisioni me 4 (katër) vota Për dhe me 3 (tri) vota Kundër e miratoi propozimin e deputetes Sala Berisha - Shala.

Amendamenti 54

Neni 72

Paragrafët 1.3; 2; 3 dhe 4 ndryshohen

Qamile Morina – Ndau mendimin për ndryshimin e paragrafit 4, sepse theksoi se nuk mund të përjashtohet Ministria e Energjisë dhe e Minierave nga ky proces.

Ky propozim nuk u miratua nga Komisioni.

Pas debatit Komisioni e nxori këtë

Përfundim

- I. Miratohen 21 amendamente të propozuara nga grupi i punës, përkatësisht gjer te neni 75 i Projektligjit;*
- II. Procesverbalit i bashkëngjiten amendamentet nga neni 54 deri në nenin 75 të Projektligjit nr. 03/L-163 për miniera dhe minerale.*

4. Të ndryshme

Mbledhja e radhës

Kryetarja – Mbledhja e radhës do të mbahet më 23. 03. 2010, në të cilën do të vazhdohet me amendamentimin e Projektligjit nr. 03/L-163 për miniera dhe minerale.

Mbledhja përfundoi në orën 13: 00.

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Myzejene Selmani